



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.121

19 shtator

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.584, datë 5.9.2007	Për kalimin në administrim të KESH sh.a.-së, të një sipërfaqeje, për ndërtimin e një TEC-i, në komunën Qendër, në veri të portit të ri të Vlorës	3411
Vendim i KM nr.586, datë 5.9.2007	Për shpërndarjen, me koeficient pjesor, të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., në administrim, me të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve.....	3411
Vendim i KM nr.587, datë 5.9.2007	Për shpërndarjen, me koeficient pjesor, të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Beno” sh.p.k., në administrim, me të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve	3412
Vendim i KM nr.588, datë 5.9.2007	Për shpërndarjen, me koeficient, të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, me të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve.....	3413
Vendim i KM nr.589, datë 5.9.2007	Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore.....	3414
Vendim i KM nr.590, datë 5.9.2007	Për caktimin e banesave të personaliteteve të larta shtetërore të vendit, të selive, rezidencave dhe objekteve të tjera shtetërore, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë.....	3415
Vendim i KM nr.595, datë 5.9.2007	Për dhënien në huapërdorje, shtabit të NATO-s, në Tiranë, të disa mjediseve në ndërtesën e Ministrisë së Mbrojtjes.....	3416

Vendim i KM nr.609, datë 12.9.2007	Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT”, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “REMI” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “EGNATIA”	3417
Vendim i MF nr.20, datë 14.9.2007	Për përcaktimin e formave të deklaramit të numrave IMEI nga importuesit dhe individët	3418
Vendim i KQZ nr.1864, datë 11.9.2007	Për korrigjimin e një gabimi material në vendimin nr.1811, datë 8.6.2007 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 18.2. 2007”	3420
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Elsa Abazaj.....	3422
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Bashkim Gorovelli ...	3422

VENDIM
Nr.584, datë 5.9.2007

**PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM TË KESH SHA-SË, TË NJË SIPËRFAQEJE, PËR
NDËRTIMIN E NJË TEC-I, NË KOMUNËN QENDËR, NË VERI TË PORTIT TË RI TË
VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në administrim të KESH sh.a.-së, për ndërtimin e një TEC-i, në komunën Qendër, në veri të portit të ri të Vlorës, të sipërfaqeve si më poshtë vijon, në pronësi të shtetit dhe në administrim të:

- Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (fondi pyjor), konkretisht: zona kadastrale 8604:

- | | |
|---------------------------------|-------------------------------|
| a) Pasuria nr.47/58, sipërfaqe | 8 500 m ² , pyll; |
| b) Pasuria nr.47/61, sipërfaqe | 7 000 m ² , pyll; |
| c) Pasuria nr.47/64, sipërfaqe | 17 000 m ² , pyll; |
| ç) Pasuria nr.47/65, sipërfaqe | 22 000 m ² , pyll; |
| d) Pasuria nr.47/67, sipërfaqe | 17 075 m ² , pyll; |
| dh) Pasuria nr.47/71, sipërfaqe | 25 000 m ² , pyll; |

Në total sipërfaqen 96 575 m², pyll.

- Qarkut të Vlorës, konkretisht: zona kadastrale 8604:

- | | |
|--------------------------------|--|
| a) Pasuria nr.47/63, sipërfaqe | 2 800 m ² , ranishte; |
| b) Pasuria nr.47/66, sipërfaqe | 2 800 m ² , rrugë (ranishte); |
| c) Pasuria nr.47/70, sipërfaqe | 34 000 m ² , ranishte; |

Në total sipërfaqen 39 600 m², ranishte.

2. Ngarkohen KESH sh.a.-ja për kryerjen e procedurave të nevojshme ligjore për regjistrimin, si asete të paluajtshme të saj, të pasurive të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a.-së dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.586, datë 5.9.2007

**PËR SHPËRNDARJEN, ME KOEFICIENT PJESOR, TË VLERAVE FINANCIARE
KREDITORËVE TË SHOQËRISË “NAHLEL” SHPK, NË ADMINISTRIM, ME TË
ARDHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETETEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kushtet dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për

hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e kreditorëve të shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., Lushnjë, në administrim sipas koeficientit të kthimit të shumave, të llogaritur si raport i të ardhurave, të realizuara dhe të depozituara, në bankë, nga shitja e aseteve, dhe e shumës së detyrimit të shoqërisë, ndaj kreditorëve.

1.1 Të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., Lushnjë, në administrim, dhe të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare, Tiranë janë 2 192 799 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

1.2 Shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “NAHLEL sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve është 27 594 790 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë.

2. Numri i kreditorëve, të cilëve do t’u shpërndahen vlerat financiare, është 259 veta.

3. Koeficienti i kthimit të shumave kreditorëve është 7.94 për qind.

4. Shpërndarja e vlerave financiare kreditorëve do të kryhet në degën e Bankës Kombëtare Tregtare, Lushnjë, sipas marrëveshjes, që do të lidhë Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., Lushnjë, me Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës Kombëtare Tregtare, Tiranë.

5. Për shërbimin e kryerjes së pagesës së kreditorëve nga Dega e Bankës Kombëtare Tregtare, Lushnjë, Grupi Mbikëqyrës do t’i paguajë bankës një komision bankar, në shumën 100 lekë për çdo kreditor, me vlerën 25 900 (njëzet e pesë mijë e nëntëqind) lekë.

6. Kjo shumë do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, e cila do t’i shtohet Grupit Mbikëqyrës, në planin financiar, të vitit 2007, zëri “shpenzime”.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë “NAHLEL” sh.p.k., në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.587, datë 5.9.2007

**PËR SHPËRNDARJEN, ME KOEFICIENT PJESOR, TË VLERAVE FINANCIARE
KREDITORËVE TË SHOQËRISË “BENO” SHPK, NË ADMINISTRIM, ME TË
ARDHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETVEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kushtet dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e kreditorëve të shoqërisë “BENO” sh.p.k., në administrim, Lushnjë, sipas koeficientit të kthimit të shumave, të llogaritur si raport i të ardhurave, të realizuara dhe të

depozituara, në bankë, nga shitja e aseteve, dhe e shumës së detyrimit të shoqërisë, ndaj kreditorëve.

1.1 Të ardhurat, e realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë “BENO” sh.p.k., në administrim, Lushnjë, dhe të depozituara në Bankën Kombëtare Tregtare, Tiranë janë 20 533 034 (njëzet milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e tridhjetë e katër) lekë.

1.2 Shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “BENO” sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve është 273 279 182 (dyqind e shtatëdhjetë e tre milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

2. Numri i kreditorëve, të cilëve do t’u shpërndahen vlerat financiare, është 10 793 veta.

3. Koeficienti i kthimit të shumave kreditorëve është 7.51 për qind.

4. Shpërndarja e vlerave financiare të kreditorëve do të kryhet në degën e Bankës Kombëtare Tregtare, Lushnjë, sipas marrëveshjes, që do të lidhë Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë “BENO” sh.p.k., Lushnjë me Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës Kombëtare Tregtare, Tiranë.

5. Për shërbimin e kryerjes së pagesës kreditorëve, Grupi Mbikëqyrës do t’i paguajë degës së Bankës Kombëtare Tregtare, Lushnjë, një komision bankar, në shumën 100 (njëqind) lekë për çdo kreditor, me vlerën e përgjithshme 1 079 300 (një milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind) lekë, si dhe shoqërisë “DATECH” sh.p.k., Tiranë, vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë për çdo kreditor, gjithsej 539 650 (pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë, për hartimin e listave përfundimtare të kreditorëve, sipas koeficientit përkatës.

6. Shuma 1 618 950 (një milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për vitin 2007, e cila do t’i shtohet Grupit Mbikëqyrës, në planin financiar, zëri “Shpenzime”.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë “BENO” sh.p.k., në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.588, datë 5.9.2007

**PËR SHPËRNDARJEN, ME KOEFICIENT, TË VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE
TË SHOQËRISË “GJALLICA” SHPK, NË ADMINISTRIM, ME TË ARDHURAT E
REALIZUARA NGA SHITJA E ASETEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë“, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e kreditorëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, sipas koeficientit të kthimit të shumave, në masën 2.41 për qind, të llogaritur si raport i të ardhurave, të realizuara dhe të depozituara në bankë, nga shitja e aseteve, e gjendjeve të llogarive bankare të kësaj shoqërie, të trashëguara, me shumën e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse ka ndaj kreditorëve.

1.1 Të ardhurat financiare, të realizuara nga shitja e asetëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, dhe të depozituara në bankë janë në shumën 937 076 530 (nëntëqind e tridhjetë e shtatë milionë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë.

1.2 Shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “Gjallica” sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve është 38 790 326 573 (tridhjetë e tetë miliardë e shtatëqind e nëntëdhjetë milionë e treqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

2. Koeficienti i kthimit të kreditorëve është 2.41 për qind.

3. Shpërndarja e vlerave financiare të kreditorëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, në rrethet Tiranë e Vlorë, të kryhet nga Banka Kombëtare Tregtare, Tiranë. Rregullat e hollësishme për mënyrën, kohën dhe radhën e shlyerjes së kreditorëve caktohen në një marrëveshje të veçantë, të lidhur ndërmjet Grupit Mbikëqyrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës Kombëtare Tregtare, Tiranë.

4. Shpenzimet për komisionin e shërbimit bankar, që do të kryhen pranë sporteve të Bankës Kombëtare Tregtare, për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, në shumën 100 (njëqind) lekë për çdo kreditor, e cila, në total, arrin vlerën 8 900 000 (tetë milionë e nëntëqind mijë) lekë, si dhe shuma 280 000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për printimin e borxhit të shoqëria “DATECH” sh.p.k., Tiranë, sipas koeficientit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Kjo shumë, në vlerën 9 180 000 (nëntë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të shtohet në planin financiar, për vitin 2007, të Grupit Mbikëqyrës, zëri “shpenzime”.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i pavarur i shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.589, datë 5.9.2007

PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME
SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Brendshme ruan dhe siguron, me punonjës të Policisë së Shtetit, objektet shtetërore, të përcaktuara në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Fondi i pagave dhe i shpenzimeve, të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, të mbulohet nga fondet buxhetore, të miratuara për Ministrinë e Brendshme.

3. Objektet, të cilat nuk përfshihen në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që, aktualisht, janë në ruajtje nga Policia e Shtetit, brenda 2 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të merren në ruajtje nga vetë subjektet.

4. Vendimet nr.112, datë 8.3.2001 “Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore”, të ndryshuar, dhe nr.390, datë 15.8.2002 “Për ruajtjen dhe sigurimin e disa objekteve shtetërore”, të ndryshuar, të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

5. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja 1

**LISTA E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME SHTETËRORE QË DO TË RUHEN
NGA POLICIA E SHTETIT**

Policia e Shtetit do të ruajë dhe sigurojë objektet e mëposhtme:

1. Selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore.
2. Godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Ushtarake dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.
3. Godina e Gjykatës Kushtetuese.
4. Godina e Gjykatës së Lartë.
5. Godina e Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës Ushtarake të Apelit.
6. Godina e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Prokurorisë për Krimet e Rënda.
7. Godinat e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore.
8. Banka e Shqipërisë e filialet e saj, si objekti “X-79” e “X-88”, Tiranë dhe shoqërimi i vlerave monetare në lëvizje.
9. Godina e Arkivit Qendror Shtetëror.
10. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin dhe Pastrimin e Parave, në Ministrinë e Financave.

VENDIM

Nr.590, datë 5.9.2007

**PËR CAKTIMIN E BANESAVE TË PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE TË
VENDIT, TË SELIVE, REZIDENCAVE DHE OBJEKTEVE TË TJERA SHTETËRORE, QË
DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d” të nenit 4 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Garda e Republikës së Shqipërisë ruan dhe mbron banesat e personaliteteve të larta shtetërore të vendit, selitë, rezidencat dhe objektet e tjera shtetërore, si më poshtë vijon:
 - a) Banesat e personaliteteve të larta shtetërore, në funksion të:
 - Presidentit të Republikës;
 - Kryetarit të Kuvendit;
 - Kryeministrit;
 - Zëvendëskryeministrit;
 - Prokurorit të Përgjithshëm;
 - Ministrit të Brendshëm.
 - b) Banesat e personaliteteve të larta shtetërore 3 (tre) vjet pas lirimit nga funksioni të:
 - Presidentit të Republikës;
 - Kryetarit të Kuvendit;
 - Kryeministrit.
 - c) Selitë:
 - Ministrinë e Punëve të Jashtme.
 - ç) Rezidencat, ku zhvillojnë veprimtari personalitetet e larta shtetërore, konkretisht:
 - Në Tiranë: Vila nr.4, Vila nr.30, Vila nr.31, Pallati i Brigadave;
 - Në Dajt: Vila nr.1, Vila nr.2;
 - Në Durrës: Vila nr.6, Vila nr.13, Vila nr.18, Vila nr.20, Vila nr.23, Vila nr.29;

- Në Vlorë: Vila nr.1, Vila nr.2, Vila nr.6, Vila nr.9;
 - Në Pogradec: Vila nr.1, Vila nr.2, Vila nr.3, Vila nr.4, Vila nr.5.
- d) Parqet dhe objektet e tjera:
- Në Tiranë: Parku i delegacioneve dhe klinika qeveritare; Parku i Kryesisë së Kuvendit.
 - Në Krrabë: Vendkomanda e përgjithshme, për kohë të veçantë dhe arkivi i Ministrisë së Brendshme.
 - Në Linzë: Objektet, ku ruhen e mbrohen rezervat, për kohë të veçantë.
 - Në Dajt: Vendkomanda e përgjithshme, për kohë të veçantë.
2. Vendimi nr.295, datë 14.5.2004 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e selive dhe të rezidencave, që do të ruhen dhe do të mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe komandanti i Gardës së Republikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.595, datë 5.9.2007

**PËR DHËNIEN NË HUAPËRDORJE, SHTABIT TË NATO-S NË TIRANË, TË DISA
MJEDISEVE NË NDËRTESEN E MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e në vijim, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe të pikës 16 të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), për statusin e NATO-s dhe të personelit të saj, ratifikuar me ligjin nr.8543, datë 4.11.1999, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në huapërdorje, për përdorim të përkohshëm, Shtabit të NATO-s, në Tiranë, të disa zyrave, me sipërfaqe truall, gjithsej 316 m², në ndërtesën e Ministrisë së Mbrojtjes.
 2. Afati i kontratës së huapërdorjes të jetë 3 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
 3. Autorizohet Ministria e Mbrojtjes të lidhë marrëveshjen teknike për kalimin, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe për përcaktimin e këtyre mjediseve.
 4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.609, datë 12.9.2007

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” NDËRMJET
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS DHE SHOQËRISË
“REMI” SH.P.K., PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “EGNATIA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT”, (ndërtim-shfrytëzim-transferim) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “REMI”, sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “EGNATIA”, sipas tekstit dhe aneksit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Këshilli i Basenit Ujëmbledhës, Shkumbin, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneks

Nr.	Emërtimi	Vlefte/lekë
	I.Punime civile	
1	Vepra e marrjes	10,202,500
2	Tubacioni lidhës vepër marrje-basen presioni D=1016/11 mm	13,622,00
3	Baseni i presionit	18,292,100
4	Tubacioni i turbinave D=1016/11-12.5 mm	71,190,000
5	Godina e centralit 600 m ²	15,000,000
6	Rrugë 5 km	4,500,000
7	N/stacioni elektrik dhe lidhja me sistemin	45,400,000
		178,206,600
	II.Makineri e pajisje	143,750,000
	Totali	321,956,600

UDHËZIM

Nr.20, datë 14.9.2007

PËR PËRCAKTIMIN E FORMAVE TË DEKLARIMIT TË NUMRAVE IMEI NGA IMPORTUESIT DHE INDIVIDËT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Personat e tatueshëm që furnizojnë aparate celularë, detyrohen të deklarojnë me shkrim pranë degës së tatimeve ku janë regjistruar, inventarin gjendje në datë 30.9.2007 të aparateve celularë.

Në listën e inventarit jepet përshkrim i hollësishëm për markën e aparatit, tipin dhe numrin IMEI, respektiv.

Dega e tatimeve protokollon deklaratën dhe e administron atë në dosjen e tatimpaguesit, për ta përdorur gjatë kontrolleve tatimore.

Një listë përmbledhëse të të gjithë inventarëve, dega e tatimeve ua dërgon zyrtarisht operatorëve të telefonisë celulare.

2. Personat e tatueshëm që merren me tregtimin e aparateve celulare duke blerë e shitur brenda vendit, detyrohen të mbajnë kopje të faturave të blerjes dhe të shitjes, ku paraqitet numri IMEI i çdo aparati.

3. Personat e tatueshëm importues të aparateve celulare dhe individët, të cilët në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është mbi minimumin e patatueshëm, krahas deklarimit nëpërmjet DAV duhet të dorëzojnë në katër kopje listën e aparateve të importuara. Në listë duhet të specifikohen qartë dhe pa gabime, marka e aparatit, tipi dhe numri IMEI.

Pas çlirimit të aparateve celulare, dega doganore shënon në listë numrin dhe datën e zhdoganimit, vulos çdo faqe me vulën zyrtare dhe dërgon zyrtarisht me postë, brenda 72 orëve, nga një kopje për çdo operator të telefonisë së lëvizshme.

4. Personat e tatueshëm importues që merren me tregtimin e aparateve celulare detyrohen të mbajnë një kopje të formularit të deklarimit në doganë të numrave IMEI të aparateve të importuara prej tyre. Njëkohësisht në faturën e lëshuar për çdo shitje, krahas informacionit të detyrueshëm me ligj, të paraqesë edhe numrin IMEI të çdo aparati që shet.

5. Kur një person i tatueshëm nuk bën deklarimet si më lart, detyrohet të paguajë një dënim në masën 10 000 lekë për çdo numër IMEI të padeklaruar.

6. Individët të cilët në çastin e hyrjes në territorin doganor shqiptar disponojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është nën minimumin e patatueshëm, të vendosur me ligj, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë pranë shërbimit doganor deklaratën “Modeli 1”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Në të gjitha rastet kur për vlerën e aparatit nuk mund të zbatohen nenet 508, 509 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, bëhet zhdoganimi i tij dhe më pas plotësohet “Modeli 1” bashkëlidhur këtij udhëzimi.

8. Formulari “Modeli 1” ka numër serial dhe plotësohet në 5 kopje.

Kopja e parë mbahet nga Dega doganore, e dyta i lihet udhëtarit dhe tri kopjet e tjera dërgohen zyrtarisht nga një për çdo operator të telefonisë së lëvizshme.

9. Ngarkohet DPD-ja të bëjë furnizimin e të gjitha doganave kufitare me formularin “Model 1” dhe të bëjë publikimin në të gjitha pikat e kalimit kufitar të detyrimit që kanë udhëtarët për deklarimin e aparateve GSM.

10. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët e saj.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MODEL 1

**DREJTORIA E PERGJITHSHME E
DOGANAVE**

Dega e Doganes _____

Dt _____

Nr serie

Firma

Vula

Deklarim Aparati Celular GSM

Emri _____ Mbiemri _____ Nr _____

Pasaporte _____

Marka _____ Tipi _____ IMEI _____

Vlera e Aparatit _____ Monedha _____

VENDIM
Nr.1864, datë 11.9.2007

**PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 1811, DATË
8.6.2007 “PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 18.2. 2007”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 10.9.2007, me pjesëmarrjen e:

Çlirim Gjata	Kryetar
Flamur Çato	Zv/Kryetar
Arben Ristani	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar
Fatmir Kumbaro	Anëtar
Genti Shala	Anëtar
Shkëlqim Hysi	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për korrigjimin e një gabimi material në vendimin nr.1811, datë 8.6.2007 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të vitit 2007”.

BAZË LIGJORE: Neni 29, pika 1 dhe 4 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

KQZ-ja, pas marrjes së të gjitha të dhënave zyrtare nga KZQV-të dhe vendimet përfundimtare gjyqësore, si dhe pas përfundimit të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor, të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, me vendimin nr.1811, datë 8.6.2007 shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 18.2.2007.

Me shkresën nr. Ekstra Prot, datë 15.8.2007, Partia Agrare Ambientaliste pretendon se gjatë këqyrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në Buletinin e Zgjedhjeve Vendore të datës 18.2.2007, ka konstatuar një gabim në ndarjen e mandateve për këshilltarët e këshillit të bashkisë Rrogozhinë. Me vendimin nr.44, datë 13.3.2007 të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë Partia Agrare Ambientaliste ka përfituar një mandat dhe në bazë të listës shumëëmërore të kësaj partie i takon z. Mustafa Hoxha, i cili merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Këshillit që nga konstituimi i tij. Ky mandat sipas Partisë Agrare Ambientaliste gabimisht i është shënuar Partisë Aleanca Demokratike.

Për sa më sipër, Partia Agrare Ambientaliste kërkon nga KQZ-ja korrigjimin e këtij gabimi material në Buletinin e Zgjedhjeve.

Nga verifikimi i vendimit nr.1811, datë 8.6.2007 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2007” rezulton se, në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për këshillin e bashkisë Rrogozhinë gabimisht Partisë Aleanca Demokratike i është shënuar 1 mandat dhe Partisë Agrare Ambientaliste 0 mandat. Në bazë të vendimit nr.44, datë 13.3.2007 të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë ky mandat i takon Partisë Agrare Ambientaliste;

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 29, pika 4 dhe nenin 2, pika 34 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

Të korrigjojë gabimin material në vendimin nr.1811 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 18.2.2007” në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për këshillin e bashkisë Rrogozhinë, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

REZULTATI PËRFUNDIMTAR I ZGJEDHJEVE TË DATËS 18.2.2007 PËR KËSHILLTARË BASHKIE, KOMUNE DHE NJËSIE BASHKIAKE

Lidhja 1

BASHKIA RROGOZHINË
RRETHI KAVAJË
QARKU TIRANË

Nr.	Subjektet që kanë paraqitur lista shumëemërore për këshilltarë	Mandate
1.	Aleanca Demokratike AD	0
2.	Bashkimi Liberal Demokrat BLD	0
3.	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar LZHK	0
4.	Lëvizja Socialiste për Integrim LSI	1
5.	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë PAA	1
6.	Partia Balli Kombëtar PBK	0
7.	Partia Demokracia Sociale PDS	0
8.	Partia Demokrate e Re PDR	2
9.	Partia Demokratike PD	3
10.	Partia Demokristiane e Shqipërisë PDK	1
11.	Partia për Drejtësi dhe Integrim PDI	1
12.	Partia Republikane Shqiptare PR	1
13.	Partia Socialdemokrate PSD	1
14.	Partia Socialiste e Shqipërisë PS	6
	Gjithsej mandate	17

KËRKESE

Shtetasi Muharrem Abazaj, banues në rrugën “Niko Avrami”, Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur të vajzës së tij, Elsa Abazaj.

KËRKUESI
Muharrem Abazaj

KËRKESE

Shtetësja Dafine Gorovelli, e bija e Vasil e Naunke, e datëlindjes 1959, banuese në Karbunarë, Lushnjë, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, Bashkim Gorovelli.

KËRKUESJA
Dafine Gorovelli

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 18.9.2007
Doli nga shtypi më 19.9.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë